**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Rep.** 234 **Nr.**
**Kol.** 90 **Nr.**

MIMOZA I. SADUSHAJ NOTER TIRANE

## KONTRATE PER SHITJE AKSIONESH

Sot me 17 / 01 / 2019 perpara meje, Noteres Mimoza Sadushaj, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, Shqiperi, me zyre ne rrugen "Vaso Pasha" pallati 13/1, ishin te pranishme palet si me poshte, te cilet nenshkruan kontraten qe vijon:

**PALA SHITESE:**

1. **ARBEN ZENELI**, i biri i Zenelit, lindur me 12.11.1967, ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. Personal G71112022Q, i perfaqesuar me prokure te posacme me nr. 1769 rep dhe nr. 1115 kol, date 31.12.2016, noteruar nga notere Margalina Dauti nga Z. Gezim Balisha, i biri i Bajramit, lindur me 14.01.1962, ne Kojel dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. 032648640 dhe nr. Personal G20114096I.

**PALA BLERESE: LAVDIJE ELEZAJ,** e bija e Ibrahimit, lindur me 20.06.1971, ne Tropoje dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. 029127511 dhe nr. Personal H15620091A.

**MEQENESE:**

I. Shitesi eshte aksioner i shoqerise "CAPITAL INVEST" Sh.a., nje shoqeri aksionare Shqiptare, e cila ushtron rregullisht veprimtarine e saj sipas legjilsacionit Shqiptar, me seli ne Rruga Pjeter Bogdani Tirane, Shqiperi, e regjistruar me date 29.06.2007, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ("**QKB**") me Numer Unik Identifikimi te Subjektit (NUIS) K72002023A.

II. Kapitali i regjistruar i Shoqerise eshte 50.000.000Leke, i ndare ne 50.000 aksione. Vlera nominale e nje aksioni eshte 1000 leke.

III. Shitesi me ane te kesaj kontrate do t'i shese Bleresit **15000 aksione (pesembedhjete mije aksione)** te zakonshme nga 23520 aksione qe Shitesi zoteron aktualisht ne kapitalin e regjistruar te Shoqerise. Aksionet qe shiten i korrespondojne **30%** (tridhjete perqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqerise ("**Aksionet ne Shitje**").

Nga aksionet ne Shitje Z.Arben Zeneli zoteron 23250aksione, te cilat perbejne 46.5% te kapitalit te shoqerise.

IV. Bleresi deshiron te bleje nga Shitesi Aksionet ne Shitje, aktualisht te zoteruar nga Shitesi;

V. Organet kompetente te Shoqerise kane marre te gjitha vendimet e nevojshme per miratimin e transferimit te pronesise se Aksioneve ne Shitje.

**PER KETO ARSYE**, Palet bien dakord si me poshte vijon:

**NENI 1**
**OBJEKTI I KONTRATES**

Sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate, Shitesi do t'i shese Bleresit dhe Bleresi do te bleje nga Shitesi, Aksionet ne Shitje si edhe te drejtat e lidhura me Aksionet ne Shitje te lira nga çdo Barre me nje çmim baraz me shumen qe përcaktohet ne nenin 2 dhe te pagueshëm sipas menyres qe përcaktohet aty.

- **Z.Arben Zeneli** shet 15.000 aksione (pesembedhjete mije) nga 23.250aksione qe ai zoteron ne shoqerine "CAPITAL INVEST", te cilat perbejne 46.5% te kapitalit. Aksionet qe shiten perbejne 30% te kapitalit te shoqerise.

**Znj. Lavdije Elezaj** blen 15.000aksione, te cilat perbejne 30% te kapitalit te shoqerise, me vlere 15.000.000leke.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate:

Z. Arben Zeneli, mbetet aksioner me 8250 aksione, te cilat perbejne 16.5% te kapitalit te shoqerise "CAPITAL INVEST" SHA.
Znj. Lavdije Elezaj, behet aksionere me 15.000 aksione, te cilat perbejne 30% te kapitalit te shoqerise "CAPITAL INVEST" SHA.

**NENI 2**

**CMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES**

Çmimi per te cilen palet kane rene dakord ne total **<u>per 15.000 Aksionet ne Shitje,</u>** eshte **15.000.000 leke**("**Cmimi i Blerjes**"), i cili eshte likuiduar totalisht nga pala blerese.

Pala shitese deklaron se pala blerese e ka likuiduar totalisht çmimin e aksioneve dhe nuk ka asnje detyrim kundrejt pales shitese.

**NENI 3**
**DETYRIMET E PALEVE**

3.1 Shitesi do te ekzekutojne dhe do te nenshkruaje dhe/ose do te mundesoje ekzekutimin dhe nenshkrimin e çdo dokumenti qe do te kerkohet sipas Ligjit Shqiptar

..e qellim qe Bleresi te fitoje nje titull te mire dhe te tregtueshem mbi Aksionet dhe per qellime te permbushjes se kesaj Marreveshje.

3.2 Shitesi dhe Bleresi kane rene dakord se do te ekzekutojne dhe do te nenshkruajne me kerkese te pare te seciles prej Paleve dhe/ose te Shoqerise çdo dokument qe do te kerkohet dhe ne pergjithesi do te kryejne te gjithe veprimet e nevojshme per regjistrimin e Transferimit te Aksioneve objekt i kesaj Kontrate, prane Regjistrit Tregtar ne QKB si edhe prane çdo autoriteti Shqiptar siç do kerkohet nga ligji Shqiptar, dhe Bleresi do te behet menjehere zoteruesi ligjor i Aksioneve ne Shitje.

3.3 Shitesi do sigurohet qe ne momentin e neshkrimit te kesaj Kontrate nuk ka asnje pengese ligjore qe Bleresi te regjistroje prane QKB-se kete Kontrate, dhe te transferoje pronesine e Aksioneve ne Shitje, ne emer te tij, dhe te siguroje Bleresin qe ai ne cilesine e aksionarit dhe Shoqeria kane status te rregullt regjistrimi prane QKB-se dhe/ose Qendres se regjistrimit te Aksioneve ("**QRA**"), dhe/ose prane cdo autoriteti publik ne Republiken e Shqiperise, dhe nuk ekziston asnje pengese ligjore per te realizuar kete transaksion, dhe per te regjistruar Bleresin si pronar te Aksioneve ne Shitje menjehere me depozitimin e kesaj Kontrate prane QKB-se, dhe/ose prane QRA-se.

**NENI 4**
**DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESIT DHE TE BLERESIT**

4.1 Shitesi deklaron dhe garanton ne lidhje me transaksionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijojne deri ne Daten e Nenshkrimit.

4.2 *Pronesia* – Shitesi eshte pronari i vetem dhe i ligjshem i Aksioneve ne Shitje. Aksionet ne Shitje jane percaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe jane shlyer plotesisht nepermjet kontributit ne para ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

4.3 *Aksionet ne Shitje* - Aksionet ne Shitje jane te lira dhe te cliruara nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe Shitesi ka te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'i shitur, per t'i kaluar, transferuar dhe dorezuar Aksionet ne Shitje ne perputhje me afatet e kasaj Kontrate. Nuk ka asnje kontrate, marreveshje ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Aksionet ne Shitje ose ndonje numer Aksionesh ne Shitje te autorizuara por te paemetuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Aksionet ne Shitje. Pervec kesaj Kontrate, nuk ka asnje kontrate, marreveshje, rregullim ose detyrim qe kerkon krijimin, dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen, ripagimin ose dhenien e se drejtes nje personi (me kusht ose jo), per te kerkuar dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e nje Aksioni ne Shitje te kapitalit te Shoqerise (perfshire por pa u kufizuar ne te drejten e parablerjes apo te kembimit). Shitesi eshte pergjegjes per cdo tatim ne lidhje me fitimin e mundshem qe realizon nga kjo shitje sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

.4 *Garanci te tjera* – Shitesi garanton Bleresin se Shoqeria eshte ne gjendje te shendetshme, dhe qe nuk ekziston asnje rrezik qe Shoqeria te kaloje ne gjendje pa-aftesie pagesash, apo asetet e luajtshme dhe/ose te paluajtshme te Shoqerise te jene subjekt padie apo prtendimi nga pale te treta.

**NENI 5**
**FORCA MADHORE**

5.1 Deshtimi i njeres pale ne permbushjen e detyrimeve sipas kesaj Kontrate, nuk do te konsiderohet shmangie apo mos-permbushje e saj, ne rastet e paraqitjes se nje Force Madhore, me kusht qe Pala e prekur prej saj te kete marre te gjitha masat e arsyeshme, te kete treguar gjithe kujdesin e nevojshem dhe te kete ndermarre masa alternative te arsyeshme per zbatimin e kesaj Kontrate si edhe (b) te kete njoftuar Palen tjeter per rrethanat e reja.

5.2 Cdo afat, ne te cilen njera Pale, ne perputhje me kete Kontrate, duhet te ndermarre nje veprim te caktuar, duhet te zgjatet ne rastin mos kryerjes se tij per shkak te shfaqes se nje Force Madhore.

**NENI 6**
**LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI KOMPETENT**

6.1 Kjo Kontrate rregullohet nga ligji shqiptar.

6.2. Cdo konflikt ne lidhje me lidhjen, interpretimin, zbatimin, zgjidhjen, perfundimin e Kontrates do te zgjidhet nga gjykatat Shqiptare.

**NENI 7**
**TE NDRYSHME**

7.1 Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim, me akt noterial dhe nenshkruhet nga/ose ne emer te seciles Pale.

7.2 Mosushtrimi ose vonesa ne ushtrimin e nje te drejte ose mase mbrojtje, qe parashikohen ne kete Kontrate ose nga ligji, nuk perben heqje dore nga e drejta ose masa e mbrojtjes, ose heqje dore nga te drejta ose masa te tjera mbrojtjeje.

7.3 Mosushtrimi i vetem ose i pjesshem i nje te drejte ose mase mbrojtjeje qe parashikohen ne kete Kontrate ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e metejshem te se drejtes ose mases mbrojtese ose ushtrimin e nje te drejte ose mase tjeter mbrojtjeje.

7.4 Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe

...eshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre dispozitave ose ...yrimeve ne nje juridiksion tjeter, nuk do te preket ose demtohet per kete shkak.

7.5 Palet do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masen me te madhe te mundshme, per te arritur qellimin e kesaj dispozite.

7.6 Asnjera Pale nuk mund te kaloje dhe / ose te transferoje te drejtat dhe / ose detyrimet sipas kesaj Kontrate, ne teresi ose ne vecanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Pales tjeter.

7.7 Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, bleresi do te paguaje shpenzimet noteriale ne lidhje me kete Kontrate.

7.8 Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote dhe zevendeson cdo marreveshje te meparshme midis Paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.

*Kjo Kontrate iu lexua Paleve, u gjend e rregullt, ne perputhje me vullnetin e tyre te plote dhe te lire, dhe u firmos perpara meje, dhe une Noterja e vertetoj ate sipas ligjit.*

**PALET**

**SHITESI**

**ARBEN ZENELI**

**I perfaqesuar me prokure nga:**

**GEZIM BALISHA**

**BLERESI**

**LAVDIJE ELEZAJ**

**NOTERE**

**MIMOZA SADUSHAJ**

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK.
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20190117121758903 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 17.01.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 12:17:58PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-219-568 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

ARBEN ZENEL ZENELI

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**Rep.** 242 **Nr.**
**Kol.** 93 **Nr.**

## KONTRATE PER SHITJE AKSIONESH

Sot me 17 / 01 / 2019 perpara meje, Noteres Violeta Sulkaj, anetare e Dhomes se Notereve Tirane, Shqiperi, ishin te pranishme palet si me poshte, te cilet nenshkruan kontraten qe vijon:

**PALA SHITESE:**

1. **ARBEN ZENELI**, i biri i Zenelit, lindur me 12.11.1967, ne Fier dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. Personal G71112022Q.
2. **LUTFI PUPLA**, i biri i Nezirit, lindur me 21.10.1963, ne Shell, Mat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. Personal G31011021Q.
3. **HYSEN MINXHOZI**, i biri i Ibrahimit, lindur me 01.03.1956, ne Mat dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. Personal F60301278Q.
4. **JULIS ZEBI**, i biri i Nejrullait, lindur me 02.03.1985, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. Personal I50302058Q.
5. **ARJAN VEIZAJ**, i biri i Xhevatit, lindur me 22.02.1958, ne Tirane dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. Personal F80222043U.

*Te perfaqesuar me prokure te posacme me nr. 1769 rep dhe nr. 1115 kol, date 31.12.2016, noteruar nga notere Margalina Dauti nga Z. Gezim Balisha, i biri i Bajramit, lindur me 14.01.1962, ne Kojel dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. 032648640 dhe nr. Personal G20114096I.*

6. **GEZIM BALISHA**, i biri i Bajramit, lindur me 14.01.1962, ne Kojel dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. 032648640 dhe nr. Personal G20114096I.

**PALA BLERESE:**

1. **ELONA MUHAMETAJ,** e bija e Driteroit, lindur me 20.07.1966, ne Tirane, dhe banues ne Tirane madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me leternjoftimin nr.033117667 dhe nr. Personal G65720215A.
2. **ARJAN SADUSHAJ**, lindur me 06.04.1957, NE Vlore dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me pasaporte me nr.F70406069H.

Elona Muhametaj    Aiola Zaja

3. **AIDA ZAJA,** e bija e Pal, lindur me 21.04.1973, ne Milot, Kruje dhe banuese ne Tirane, madhore me zotesi te plote jurdike per te vepruar, identifikuar me leternjoftim me nr. 024482989 dhe nr. Personal H35421122J.

**MEQENESE:**

I. Shitesit jane aksionare te shoqerise "CAPITAL INVEST" Sh.a., nje shoqeri aksionare Shqiptare, e cila ushtron rregullisht veprimtarine e saj sipas legjilsacionit Shqiptar, me seli ne Rruga Pjeter Bogdani Tirane, Shqiperi, e regjistruar me date 29.06.2007, e regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit ("**QKB**") me Numer Unik Identifikimi te Subjektit (NUIS) K72002023A.

II. Kapitali i regjistruar i Shoqerise eshte 50.000.000Leke, i ndare ne 50.000 aksione. Vlera nominale e nje aksioni eshte 1000 leke.

III. Shitesit deshirojne bashkarisht t'i shesin Bleresve **22500 aksione (njezet e dymije e peseqind aksione)** te zakonshme qe Shitesit zoterojne bashkarisht aktualisht ne kapitalin e regjistruar te Shoqerise, qe i korrespondojne **45%** (dyzet e pese perqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqerise ("**Aksionet ne Shitje**").

Nga aksionet ne Shitje :
**Z. Julis Zebi** zoteron 2450 aksione, te cilat perbejne 4.9% te kapitalit.
**Z. Arian Veizaj** zoteron 1960 aksione, te cilat perbejne 3.92% te kapitalit.
**Z.Arben Zeneli** zoteron 8250aksione, te cilat perbejne 16.5% te kapitalit.
**Z. Lutfi Pupla** zoteron 2450 aksione, te cilat perbejne 4.9% te kapitalit.
**Z. Hysen Minxhozi,** zoteron 2450 aksione, te cilat perbejne 4.9% te kapitalit.
**Z. Gezim Balisha,** zoteron 17440 aksione, te cilat perbejne 34.88% te kapitalit, nga te cilat me ane te kesaj kontrate shet 4940 aksione te cilat perbejne 9.88% te kapitalit.

IV. Bleresit deshirojne te blejne nga Shitesit Aksionet ne Shitje, aktualisht te zoteruara nga Shitesit;

V. Organet kompetente te Shoqerise kane marre te gjitha vendimet e nevojshme per miratimin e transferimit te pronesise se Aksioneve ne Shitje.

**PER KETO ARSYE**, Palet bien dakord si me poshte vijon:

## NENI 1
## OBJEKTI I KONTRATES

Sipas kushteve dhe afateve te kesaj Kontrate, Shitesit do t'i shesin Bleresve dhe Bleresit do te blejne nga Shitesit, Aksionet ne Shitje si edhe te drejtat e lidhura me Aksionet ne Shitje te lira nga çdo Barre me nje çmim baraz me shumen qe përcaktohet ne nenin 2 dhe te pagueshëm sipas menyres qe përcaktohet aty.

- **Z. Julis Zebi** shet 2450 aksione, te cilat perbejne 4.9% te kapitalit.

- **Z. Arian Veizaj** shet 1960 aksione, te cilat perbejne 3.92% te kapitalit.
- **Z.Arben Zeneli** shet 8250aksione, te cilat perbejne 16.5% te kapitalit.
- **Z. Lutfi Pupla** shet 2450 aksione, te cilat perbejne 4.9% te kapitalit.
- **Z. Hysen Minxhozi,** shet 2450 aksione, te cilat perbejne 4.9% te kapitalit.
- **Z. Gezim Balisha,** shet 4940 aksione te cilat perbejne 9.88% te kapitalit nga 17440 aksione, te cilat perbejne 34.88% te kapitalit, qe ai zoteron ne shoqerine "CAPITAL INVEST" SH.A

**Bleresja Elona Muhametaj** blen 15.000aksione, te cilat perbejne 30% te kapitalit te shoqerise, me vlere 15.000.000leke.
**Bleresi Arjan Sadushaj**, blen 2500 aksione, te cilat perbejne 5% te kapitalit te shoqerise, me vlere 2.500.000leke.
**Bleresja Aida Zaja,** blen 5000 aksione, te cilat perbejne 10% te kapitalit te shoqerise, me vlere 5.000.000leke.

Pas nenshkrimit te kesaj kontrate:

- Znj. Elona Muhametaj, behet aksioner i shoqerise me 15.000 aksione, te cilat perbejne 30% te kapitalit te shoqerise;
- Z. Arjan Sadushaj, behet aksioner i shoqerise me 2500aksione, te cilat perbejne 5% te kapitalit te shoqerise;
- Z. Aida Zaja, behet aksioner i shoqerise me 5000aksione, te cilat perbejne 10% te kapitalit te shoqerise;
- Z. Gezim Balisha, mbetet aksioner i shoqerise me 12.500aksione, te cilat perbejne 25% te kapitalit te shoqerise.
- Aksioneret Julis Zebi, Arian Veizaj, Arben Zeneli, Lutfi Pupla, dhe Hysen Minxhozi largohen nga shoqeria "CAPITAL INVEST" SHA.

## NENI 2

## ÇMIMI I BLERJES DHE MENYRA E PAGESES

Çmimi per te cilen palet kane rene dakord ne total **per 22.500Aksionet ne Shitje,** per te gjithe Shitesit bashkarisht eshte **22.500.000 leke**("**Cmimi i Blerjes**"), i cili i eshte paguar totalisht shitesve.

Shitesit deklarojne se bleresit e kane likudiuar totalisht çmimin e shitjes dhe nuk kane asnje detyrim kundrejt shitesve.

## NENI 3
## DETYRIMET E PALEVE

3.1 Shitesit do te ekzekutojne dhe do te nenshkruaje dhe/ose do te mundesoje ekzekutimin dhe nenshkrimin e çdo dokumenti qe do te kerkohet sipas Ligjit Shqiptar me qellim qe Bleresi te fitoje nje titull te mire dhe te tregtueshem mbi Aksionet dhe per qellime te permbushjes se kesaj Marreveshje.

3.2 Shitesit dhe Bleresit kane rene dakord se do te ekzekutojne dhe do te nenshkruajne me kerkese te pare te seciles prej Paleve dhe/ose te Shoqerise çdo dokument qe do te kerkohet dhe ne pergjithesi do te kryejne te gjithe veprimet e nevojshme per regjistrimin e Transferimit te Aksioneve objekt i kesaj Kontrate, prane Regjistrit Tregtar ne QKB si edhe prane çdo autoriteti Shqiptar siç do kerkohet nga ligji Shqiptar, dhe Bleresi do te behet menjehere zoteruesi ligjor i Aksioneve ne Shitje.

3.3 Shitesit do sigurohen qe ne momentin e neshkrimit te kesaj Kontrate nuk ka asnje pengese ligjore qe Bleresi te regjistroje prane QKB-se kete Kontrate, dhe te transferoje pronesine e Aksioneve ne Shitje, ne emer te tij, dhe te siguron Bleresin qe ai ne cilesine e aksionarit dhe Shoqeria kane status te rregullt regjistrimi prane QKR-se dhe/ose Qendres se regjistrimit te Aksioneve (“**QRA**”), dhe/ose prane cdo autoriteti public ne Republiken e Shqiperise, dhe nuk ekziston asnje pengese ligjore per te realizuar kete transaksion, dhe per te regjistruar Bleresin si pronar te Aksioneve ne Shitje menjehere me depozitimin e kesaj Kontrate prane QKB-se, dhe/ose prane QRA-se.

## NENI 4
## DEKLARIMET DHE GARANCITE E SHITESIT DHE TE BLERESIT

4.1 Shitesit deklarojne dhe garanton ne lidhje me transaksionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijojne deri ne Daten e Nenshkrimit.

4.2 *Pronesia* – Shitesi eshte pronari i vetem dhe i ligjshem i Aksioneve ne Shitje. Aksionet ne Shitje jane percaktuar dhe emetuar rregullisht si dhe jane shlyer plotesisht nepermjet kontributit ne para ne kapitalin themeltar te Shoqerise.

4.3 *Aksionet ne Shitje* - Aksionet ne Shitje jane te lira dhe te cliruara nga cdo Barre e cfaredo lloji dhe Shitesit kane te gjitha te drejtat, kompetencen dhe autorizimin e plote per t'i shitur, per t'i kaluar, transferuar dhe dorezuar Aksionet ne Shitje ne perputhje me afatet e kasaj Kontrate. Nuk ka asnje kontrate, marreveshje ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Aksionet ne Shitje ose ndonje numer Aksionesh ne Shitje te autorizuara por te paemetuara ne kapitalin e Shoqerise. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje te drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Aksionet ne Shitje. Pervec kesaj Kontrate, nuk ka asnje kontrate, marreveshje, rregullim ose detyrim qe kerkon krijimin, dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen, ripagimin ose dhenien e se drejtes nje personi (me kusht ose jo), per te kerkuar dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e nje Aksioni ne Shitje te kapitalit te Shoqerise (perfshire por pa u kufizuar ne te drejten e parablerjes apo te kembimit). Shitesi eshte pergjegjes per cdo tatim ne lidhje me fitimin e mundshem qe realizon nga kjo shitje sipas legjislacionit ne fuqi ne Republiken e Shqiperise.

4.4 *Garanci te tjera* – Shitesit garantojne Bleresin qe Shoqeria eshte ne gjendje te shendetshme, dhe qe nuk ekziston asnje rrezik qe Shoqeria te kaloje ne gjendje pa-

aftesie pagesash, apo asetet e luajtshme dhe/ose te paluajtshme te Shoqerise te jene subjekt padie apo prtendimi nga pale te treta.

## NENI 5
## FORCA MADHORE

5.1 Deshtimi i njeres pale ne permbushjen e detyrimeve sipas kesaj Kontrate, nuk do te konsiderohet shmangie apo mos-permbushje e saj, ne rastet e paraqitjes se nje Force Madhore, me kusht qe Pala e prekur prej saj te kete marre te gjitha masat e arsyeshme, te kete treguar gjithe kujdesin e nevojshem dhe te kete ndermarre masa alternative te arsyeshme per zbatimin e kesaj Kontrate si edhe (b) te kete njoftuar Palen tjeter per rrethanat e reja.

5.2 Cdo afat, ne te cilen njera Pale, ne perputhje me kete Kontrate, duhet te ndermarre nje veprim te caktuar, duhet te zgjatet ne rastin mos kryerjes se tij per shkak te shfaqes se nje Force Madhore.

## NENI 6
## LIGJI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI KOMPETENT

6.1Kjo Kontrate rregullohet nga ligji shqiptar.

6.2 Cdo konflikt ne lidhje me lidhjen, interpretimin, zbatimin, zgjidhjen, perfundimin e Kontrates do te zgjidhet nga gjykatat Shqiptare.

## NENI 7
## TE NDRYSHME

7.1 Cdo shtese, ndryshim, zgjidhje ose heqje dore nga ndonje prej dispozitave te kesaj Kontrate, do te jete e vlefshme vetem nese behet me shkrim, me akt noterial dhe nenshkruhet nga/ose ne emer te seciles Pale.

7.2 Mosushtrimi ose vonesa ne ushtrimin e nje te drejte ose mase mbrojtje, qe parashikohen ne kete Kontrate ose nga ligji, nuk perben heqje dore nga e drejta ose masa e mbrojtjes, ose heqje dore nga te drejta ose masa te tjera mbrojtjeje.

7.3 Mosushtrimi i vetem ose i pjesshem i nje te drejte ose mase mbrojtjeje qe parashikohen ne kete Kontrate ose nga ligji, nuk pengon ushtrimin e metejshem te se drejtes ose mases mbrojtese ose ushtrimin e nje te drejte ose mase tjeter mbrojtjeje.

7.4 Ne rast se nje dispozite ose detyrim sipas kesaj Kontrate eshte i pavlefshem, i paligjshem ose i pazbatueshem ne nje juridiksion, vlefshmeria, ligjshmeria dhe zbatueshmeria e dispozitave ose detyrimeve te tjera, ose e ketyre dispozitave ose detyrimeve ne nje juridiksion tjeter, nuk do te preket ose demtohet per kete shkak.

7.5 Palet do te perpiqen te zevendesojne nje dispozite te pazbatueshme ose te pavlefshme, ne masen me te madhe te mundshme, per te arritur qellimin e kesaj dispozite.

7.6 Asnjera Pale nuk mund te kaloje dhe / ose te transferoje te drejtat dhe / ose detyrimet sipas kesaj Kontrate, ne teresi ose ne vecanti, pa miratimin paraprak me shkrim te Pales tjeter.

7.7 Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, bleresi do te paguaje shpenzimet noteriale ne lidhje me kete Kontrate.

7.8 Kjo Kontrate perben marreveshjen e plote dhe zevendeson cdo marreveshje te meparshme midis Paleve qe lidhet me objektin e kesaj Kontrate.

*Kjo Kontrate iu lexua Paleve, u gjend e rregullt, ne perputhje me vullnetin e tyre te plote dhe te lire, dhe u firmos perpara meje, dhe une Noterja e vertetoj ate sipas ligjit.*

**PALET**

**SHITESIT**

**JULIS ZEBI**
**ARIAN VEIZAJ**
**ARBEN ZENELI**
**LUTFI PUPLA**
**HYSEN MINXHOZI**
**Te perfaqesuar me prokure nga:**

**GEZIM BALISHA**

**GEZIM BALISHA**

**BLERESIT**

**ELONA MUHAMETAJ**

**ARJAN SADUSHAJ**

**AIDA ZAJA**

**NOTERE**

**VIOLETA SULKAJ**

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20190117135240934 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 17.01.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 1:52:40PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-010-2051 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

**LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0**

JULIS NEJRUDHAH ZEBI
CAPITAL INVEST SH.A.
ARJAN XHEVAT VEIZAJ
GEZIM BAJRAM BALISHA

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

gjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibres, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia", Kati V
TIRANE, SHQIPERI
TEL/FAX.:355 4 2420005
TEL:355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

## REZULTATET E KËRKIMIT

| | |
|---|---|
| Numri i Rezultatit te Kerkimit: | D-20190117134921372 |
| Data e Rezultatit te Kerkimit: | 17.01.2019 |
| Ora e Rezultatit te Kerkimit: | 1:49:21PM |
| Lloji i Kerkimit: | |
| Numri i Dokumentit: | D-400-010-2050 |
| Referenca e Perdoruesit: | |

'ERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

ARBEN ZENEL ZENELI
LUTFI NEZIR PUPLA
HYSEN IBRAHIM MINXHOZI

REGJISTRI I BARREVE SIGURUESE R.B.S. TIRANË - ALBANIA

.e
n
ne
ne
es
ne
es
ne
ne
ne
es
ne
ate
nit,
ike
nal
nes
me
lhe
uar
ne,
me



1